



## **NDIKIMI I DIGJITALIZIMIT NË OFRIMIN E SHËRBIME NDAJ QYTETARËVE**

BLERINA GUGA  
EDITA SHOSHI  
ELKANA ZYKAJ  
SANIELA XHAFERRI  
ZOICA BARDHI

## Tabela e lëndës

HYRJE .....	2
METODOLOGJIA.....	4
Digjitalizimi dhe përdorimin i TIK në funksion të sigurisë së pasurive të paluajtshme në Shqipëri .....	6
<u>Turizmi, TIK dhe Agjenda Shqipëria Digjitale.....</u>	8
<u>e-shërbimet konsullore dhe avantazhet e përdorimit të teknologjisë .....</u>	11
<u>EBC në vend të ABC: eEdukimi dhe arsimit shqiptar në rrjet.....</u>	13
<u>Aneks 1 Përmbledhje e bazës ligjore mbi digjitalizimin në Shqipëri .....</u>	17

Ky dokument u prodhua si pjesë e inisiativave publike të pjesëmarrësve të “Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike” dhe u mbështet nga Akademia e Studimeve Politike. Ofrimi i ekspertizës profesionale të këtyre hulumtimeve ndaj politikëbërësve synon të sigurojë një platformë diskutimesh për shkëmbimin e ndërsjelltë të ideve të reja.

## HYRJE

Punimi “Ndikimi i Dixhitalizimit në Ofrimin e Shërbime Ndjaj Qytetarëve 2015 – 2019” synon të sjellë një fotografi të ndikimit të përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe mjeteve të saj në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në nivel vendor dhe qendror të qeverisjes në vend, në periudhën kohore 2015 – 2019 nën dritën e katër prej 12 parimeve të mirëqeverisjes të Këshillit të Evropës<sup>1</sup> si më poshtë.

### *Parimi 2 – Përgjegjshmëria*

- a. Bëhet përshtatja e objektivave, rregullave, strukturave dhe procedurave me pritshmëritë legjitime dhe nevojat e qytetarëve.
- b. Ofrohen shërbimet publike dhe iu jepet përgjigje kërkesave dhe ankesave brenda një kuadri kohor të arsyeshëm.

### *Parimi 3 – Efikasiteti dhe Efektshmëria*

- a. Rezultatet janë pasqyrim i objektivave për të cilat është rënë dakord.
- b. Burimet e disponueshme përdoren në mënyrën më të mirë të mundshme.
- c. Sistemet e menaxhimit të performancës bëjnë të mundur vlerësimin dhe përmirësimin e efikasitetit dhe efektshmërisë së shërbimeve.
- d. Bëhen auditime në interval periodike për të vlerësuar dhe për të përmirësuar performancën.

### *Parimi 4 – Të Qenurit i Hapur dhe Transparenca*

- a. Vendimet merren dhe zbatohen në përputhje me rregullat dhe rregulloret.
- b. Publiku ka akses tek i gjithë informacioni që nuk është i klasifikuar për arsye të specifikuara mirë, siç parashikohet në ligj (si mbrojtja e privacisë apo garantimi i ndershmërisë së procedurave të prokurimit).
- c. Informacioni për vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet bëhen të disponueshme për publikun në mënyrë të atillë që i mundësojnë këtij të fundit të ndjekë punën e autoritetit vendor dhe të kontribuojë në mënyrë efikase në të.

### *Parimi 8 – Novacioni dhe të Qenurit i Hapur ndaj Ndryshimeve*

- a. Kërkohen zgjidhjet e reja dhe efikase për problemet dhe për këtë përfitohet nga metodat moderne të sigurimit të shërbimit.
- b. Ekziston gatishmëria për të pilotuar dhe eksperimentuar me programet e reja dhe për të mësuar nga përvoja e të tjerëve.
- c. Një klimë e favorshme për ndryshim krijohet në interes të qëllimit për rezultate më të mira.

<sup>1</sup> <https://rm.coe.int/12-principles-of-governance-poster-a2/1680787986>

Digjitalizimi është revolucioni i katërt industrial i njerëzimit si e njohim, dhe i ka fillimet në mesin e viteve 1960 me përdorimin e kompjuterit dhe mikroçipeve, dhe kulmoi në fundin e viteve 1990 kur investimet botërore në industrinë e prodhimit dhe përdorimit të softwareve tejkaluan investimet në industrinë e rëndë, dhe teknologjia e ndërlihdjes në rrjet (internet) ndryshoi njëherë e përgjithnjë komunikimin dhe shkëmbimet mes njerëzve<sup>2</sup>.

Që prej fillimit të mijëvjeçarit të ri, flitet për revolucionin e 4<sup>rt</sup> industrial ose Industria 4.0 ku niveli i ndërveprimit mes njerëzve dhe pajisjeve apo këtyre të fundit mes njeri tjetrit, në ofrimin e shërbimeve dhe prodhim ka kaluar në një nivel tjetër. Analizat dhe hulumtimet të Organizatës Botërore për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin – OECD, ofrojnë përparësitë e pamohueshme dhe defektet në menaxhimin e teknologjisë së informacionit në ekonominë dhe mirëqeverisjen globale, sfidat dhe risqet që vijnë me rritjen e saj, por nuk ka kthim pas, dhe sfida madhore mbetet maksimizimi i përdorimit të TIK në ekonomi, punësim, shërbime dhe mirëqenie.

Studimi që vijon, është bazuar në Strategjinë Evropa 2020<sup>3</sup>, dhe planit e veprimit të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur (Open Governance Initiative)<sup>4</sup>, në Strategjinë Ndërsektoriale Agjenda Shqipëria Digjitale 2015-2020, të miratuar me VKM nr 284 datë 01.04.2015, e cila ka prioritet të parë strategjik të saj, **Politikat për zhvillimin e qeverisjes elektronike dhe ofrimin e shërbimeve publike interaktive për qytetarët dhe bizneset**<sup>5</sup>.

Me fokus tek shërbimet digjitale të ofruara ndaj qytetareve, nivelin e aksesit dhe njohurive mbi to si dhe nivelin e kënaqësisë së përdorimit të tyre, ky punim sjell një pamje të sa më sipër, 4 vjet pas miratimit të Agjendës Shqipëria Digjitale 2020 dhe aktivizimit të portalit e-Albania dhe shërbimeve të tjera digjitale në menaxhimin të pasurive të paluajtshme, shërbimet konsullore, ato të turizmit, dhe arsimit para universitar.

Punimi sjell si aneks edhe përmbledhjen e bazës ligjore që ka mundësuar prezantimin dhe përdorimin e mjeteve të teknologjisë së informacionit në qeverisjen vendore dhe qendrore në vend.

Numri i përdoruesve të Internetit) në Shqipëri raportohet 1.8 milionë, në tremujorin e katërt të vitit 2018<sup>6</sup> duke ju dhënë akses në shërbimet elektronike një numri shumë të madh qytetaresh po a përdoren këto lehtësira për marrjen e shërbimeve dhe sa të informuar janë qytetarët për to?

Portali qeveritar e-Albania ofron sot 600 shërbime elektronike dhe 36 dokumente me vullë elektronike<sup>7</sup>, duke shkurtuar në mënyrë shumë të ndjeshme kostot financiare dhe kohore në marrjen

---

<sup>2</sup> <https://www.weforum.org/reports/how-to-end-a-decade-of-lost-productivity-growth>

<sup>3</sup> <http://ec.europa.eu/digital-agenda>

<sup>4</sup> <https://www.opengovpartnership.org/members/albania/>

<sup>5</sup> [http://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Strategjia\\_Axhenda\\_Dixhitale\\_e\\_Shqiperise\\_2015-2020.pdf](http://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Strategjia_Axhenda_Dixhitale_e_Shqiperise_2015-2020.pdf)

<sup>6</sup> Raporti Vjetor i Veprimtarisë 2018 – AKEP/ Raport\_Monitorimit\_te\_AD-R1-final\_-\_20\_Korrik\_2016.pdf

<sup>7</sup> [http://www.adisa.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Sherbime-me-vule-dixhitale\\_Kodet\\_ADISA.pdf](http://www.adisa.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Sherbime-me-vule-dixhitale_Kodet_ADISA.pdf)

e shërbimeve. Treguesit janë në dukje pozitivë, por ende në më pak se 50% të objektivave të Strategjisë në më pak se një vit e katër muaj nga mbyllja e kësaj strategjie më 2020<sup>8</sup>.

Raport progresi i BE për Shqipërinë 2019<sup>9</sup> e cilëson këtë një arritje cilësore, megjithatë ka shumë sfida për tu përballur për sa i përket mbulimit me shërbimin e internetit në zonat rurale dhe pak të zhvilluara dhe përmirësimit të infrastrukturës dhe koordinimit institucional për sigurimin e vazhdueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së arritjeve të deritanishme të kësaj strategjie.

## METODOLOGJIA

Punimi që vijon sjell një fotografi të ndikimit të përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe mjeteve të saj në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në nivel vendor dhe qendror të qeverisjes në vend, në periudhën kohore 2015 – 2019 në respektim të një prej 12 parimeve të mirëqeverisjes, dhe Efikasitetit dhe Efektshmërisë në shërbime, duke ndjekur prioritetet e Strategjisë Ndërsektoriale Agjenda Shqipëria Digjitale 2015-2020

Raporti i vetëm i monitorimit të Agjendës Shqipëria Digjitale, i vitit 2016, është sa bazë për analizën e bërë në këtë punim, edhe indikator që plani i saj i veprimit ka ngadalësuar hapin pas shkrirjes së ministrisë përgjegjëse asaj për Inovacionin dhe Administratës Publike në vitin 2017.

Gjithsesi shumë hapa janë hedhur, por nevojitet një përqasje më strategjike në lidhje me njohjen dhe përdorimin e TIK nga qytetarët për marrjen e e-shërbimeve, që prej edukimit shkollor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Duke ndjekur periudhën kohore të mbuluar edhe nga Strategjia Ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë” (2015-2020), ky punim sjell një analizë të zhvillimeve në drejtim të digjitalizimit të shërbimeve ndaj qytetarëve në tre fusha, nisur edhe nga përvoja dhe angazhimi profesional i anëtarëve të grupit të punës.

Raporti i Monitorimit të Strategjia Ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë” i vitit 2016, është i vetmi dokument i aksesueshëm që na jep japin të dhëna dhe orientim mbi ndarjen e detyrave dhe buxheteve të ministrive të linjës në përmbushje të objektivave të saj. Mungesa e një raporti monitorimi më të përditësuar, e bën të vështirë ndjekjen e realizimit të të gjithë objektivave të saj, megjithatë grupi i punës ka arritur të analizojë faktorë që flasin për këtë.

Nga një analizë e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021<sup>10</sup>, vërejmë se në funksion të objektivave të Agjendës Digjitale, pasqyrohen në Prioritetet buxhetore afatmesme 2019 – 2021, dy

<sup>8</sup> <http://www.gazetatema.net/2014/12/04/harito-ne-samitin-e-berlinit-1300-sherbime-drejt-digjitalizimit/>

<sup>9</sup> <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

<sup>10</sup> <https://financa.gov.al/programi-buxhetor-afatmesem-2019-2021-faza-ii/>

ndër 5 prioritetet, (**Modernizimi i shërbimeve publike dhe Menaxhimi i integruar i tokës**) janë buxhetuar më respektivisht me 1.3 miliardë lekë dhe 6 miliardë lekë në vit.

Turizmi, shërbimet konsullore, administrimi i pasurive të paluajtshme dhe arsimit janë në objektivat e këtij punimi, duke ofruar një analizë të bazuar në hulumtimin e kuadrit ligjor mbi digjitalizimin e shërbimeve dhe përdorimin e mjeteve të ICT mirëqeverisje dhe ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Analiza e Strategjisë Ndersektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2015-2020” dhe e raportit të saj të vetëm të monitorimit, botuar në Korrik të 2016 dhe vijimësia dhe rezultatet e projekteve qeveritare me fokus digjitalizimin e shërbimeve është qasja e dytë metodologjike në punim.

## **Digjitalizimi dhe përdorimin i TIK në funksion të sigurisë së pasurive të paluajtshme në Shqipëri.**

Procesi i rregullimit dhe përditësimit të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme, konsiderohet si një nga aktivitetet më të rëndësishëm, në funksion të sigurisë së pasurive të paluajtshme në shqipëri. Reformat e privatizimit të tokës dhe të ndërtimeve, në 25 vitet e fundit kanë qënë shumë të shpejta. Shqipëria doli nga sistemi monist pa një institucion të specializuar për regjistrimin e të drejtave të pasurive dhe garantimin e tregut të tokës.

Sistemi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme është sistem informacioni që është parashikuar me ligj dhe me rregullore të përditesohet në mënyrë të vazhdueshme. Ky përditësim i informacionit të pasurive është bërë dhe vazhdon të bëhet nëpërmjet përditësimit të hartave, kartelave dhe dokumentave në formën e letrës. Në këtë dokument kur përmendet termi “Përditësim”, (shpesh herë mund të jetë përdorur edhe termi “Azhornim”), merret parasysh **përditësimi i të dhënave dixhitale të hartave kartelave dhe dokumentave.**

**Digjitalizimi** i hartave në Programe Kompjuterike (AutoCad, ArcGis) është procesi i shndërrimit të të dhënave gjeografike qoftë nga një kopje fizike ose nga një imazh i skanuar në të dhëna vektoriale.

Gjatë 25 viteve të fundit në Shqipëri janë trajtuar me vendime nga Gjykata, Drejtori, Komisione dhe zyrat rajonale çështje të ndryshme të pronësisë të cilat janë dhënë ose janë hequr në terren ose vetëm me letra por asnjëherë të harmonizuara apo të integruara me njëra tjetrën. Institucionet e ndryshme kanë një koordinim jo të mjaftueshëm mes tyre, kjo për arsye dhe të punimit me harta të ndryshme nga secili institucion.

Po të shohim punën e Institucioneve të Hipotekës dhe Aluiznit vërejmë se hartat që përdoren nuk janë të njëjta. Nga bashkërendimi institucional dhe korrespondenca që ndiqet për të bërë verifikimin ligjor të një pronë, Institucionet që merren me çështjet e pronësisë ndodhen përpara fakteve dhe problemeve jo të vogla të akumuluar gjatë viteve dhe si shkak i ndërrimit të sistemeve, në momentin e konfrontimit të hartave me njëra-tjetrën për të bërë verifikimin dhe identifikimin e parcelave përkatëse në shumicën e rasteve ndodhemi përpara mosperputhjes së dokumentit hartografik, mbivendosjeve të pronave njëra me tjetrën, mosperputhjes së parcelave etj, duke e bërë të pamundur shpesh-herë identifikimin e vetëpronës.

Kur bëhet fjalë për funksionalitetin dhe saktësinë e të dhënave të hartave në dispozicion, hartat digjitale kanë përparësi të dukshme, dhe unifikimi i të gjitha hartave të institucioneve që merren me çështjet e pronësisë në një sistem të vetëm do ishte zgjidhja ideale për stabilizimin e gjendjes së pronës dhe evitimin e problemit të mbivendosjes së pronave i cili në Shqipëri është i përhapur masivisht.

### **Përparësitë e digjitalizimit dhe të unifikimit të hartave janë:**

- 1) Digjitalizimi i hartave në Shqipëri mund të shmangë dhe të zgjidhë problemin e mbivendosjes së pronave.
- 2) Saktësia e hartave digjitale është shumë më e madhe se e hartave në formatin letër.

3) Me anë të digjitalizimit fitohet shpejtësi dhe gatishmëri në shërbim të qytetarëve si dhe ka një kosto më të ulët se formati letër.

4) Digjitalizimi i hartës ndihmon në përmirësimin e efikasitetit të procesit dhe cilësinë e hartës.

5) Digjitalizimi vë në pah dhe historikun e regjistrimeve të vjetra si dhe identifikimet e pronarit me pronën ndër vite.

Gjithsesi në aspektin e digjitalizimit të shërbimeve që jepen në lidhje me çështjet e pronësisë duhet thënë së Shqipëria ka bërë një përparim të dukshëm duke ulur afatet e dhënies së informacionit dhe rritjen e efikasitetit të shërbimit të ofruar. Kjo nëpërmjet eliminimit të radhëve të gjata të pritjes nëpër sporteleve të institucioneve nga njëra anë dhe me vënien në efikasitet të plotë të të gjithë punonjësve të institucionit në përpunimin e dosjeve në proces me krijimin e ADISA-S (Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara), e cila u krijua për të rritur shkallën e mirëfunksionimit dhe të transparencës së veprimtarisë së administratës në raport me kërkesat e publikut si premisë për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së vete cila u krijua me VKM nr. 693, datë 22.10.2014<sup>11</sup> dhe shpejtësisë së dhënies së informacionit nëpërmjet digjitalizimit të një pjese të madhe të të dhënave të kartelave të pasurive, sepse dokumentacioni nuk jepet më i shkruar me dorë por kartelat e pasurive të cilat ishin me përpara në volume të ndryshme tashmë janë të kompjuterizuar dhe me një komandë printohet kartela e freskët ose çdo informacion që kërkohet masivisht nga qytetarët, jepet në mënyrë elektronike.

Gjithashtu portali e-Albania mund të cilësohet si një inovacion madhor në dhënien e shërbimeve publike të digjitalizuar që gjenden në zyrat dhe sportelet fizike të institucioneve të cilat tashmë ofrohen në mënyrë elektronike, kryesisht janë dokument të cilat kanë një kërkesë më të madhe nga qytetarët si p.sh., kopje të certifikatës së pronësisë apo vërtetime pozitive/negative për pasjen ose jo të pronave në pronësi të cilat mund të merren lehtësisht nga kompjuteri dhe pa asnjë kosto, thjeshtë duke përdorur ID- personale.

Pavarësisht ekzistencës së njëligji mbi regjistrimin e pasurive të paluajtshme, sistemi i regjitrimit duhet të zhvillojë në mënyrë të vazhdueshme ambjentin rregullativ tekniko-ligjor, në funksion të sigurisë së tregut të pasurive. Në kushtet kur institucionet e ndryshme kanë një koordinim jo të mjaftueshëm mes tyre, dhe njëkohësisht kanë prodhuar e prodhojnë dokumenta pronësie me probleme teknike e ligjore, regjistrimi i të drejtave të pasurive dhe garantimi i tregut të tyre bëhet edhe më i vështirë. Në Shqipëri ka nevoja të mëdha për përmirësim në fushën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe garantimit të tregut!

Vërejmë se procesi i dixhitalizimit të informacioneve të pasurive, në momentin për të cilin flet dokumenti, ka për qëllim kontrollin e cilësisë së informacionit dhe rritjen e shpejtësisë së operimit me të. Informacioni dixhital i prodhuar nga ky proces ende nuk zëvendëson vlerën ligjore të informacionit në formën e letrës.

---

<sup>11</sup><http://www.adisa.gov.al/wp-content/uploads/2016/05/01-Rregullore-e-organizimit-dhe-funksionimit-te-administrates-se-ADISA.pdf>



Përpjekje dhe arritje në këtë sektor ka dhe duhet të shërbejnë si modele pozitive për referencë dhe huazim nga institucionet shtetërore për tu përdorur në lehtësim të reformës së vështirë të administrimit të pasurive të paluajshme në vend. Digjitalizimi i të dhënave kadastrale dhe kufijve të pasurive për tokën që ka kaluar projekti TAP provon së jo vetëm është e mundur, por edhe fakt i kryer ka kohezion me aktorëve dhe vullnet për zhvillim.<sup>12</sup>

## Turizmi, TIK dhe Agjenda Shqipëria Digjitale

Sektori i Turizmit, është një ndër ata prioritarë të trajtuar dhe buxhetuar në kuadër të Agjendës Digjitale 2015 -2020. Objektivi i 7<sup>të</sup> i saj “*Minimizimi i dallimeve digjitale midis rajoneve dhe qyteteve nëpërmjet rritjes së aksesit të internetit në 70% dhe përmirësimit të cilësisë së jetesës në nivelin 30%.*, pika 6 ...”Ngritja e platformave digjitale të përqendruara apo rajonale në shërbim të bujqësisë dhe turizmit” kanë qenë premisa dhe argumentim për financimin e 13 projekteve me vlerë totale 201 milionë Lekë, në funksion të kësaj strategjie.

Aktualisht dokumenti i Strategjisë Kombëtare për Turizmin, 2019 - 2023<sup>13</sup> e rendit digjitalizimin dhe përdorimin e paket të teknologjisë së informacionit në turizëm ndër pikat e dobëta për tu adresuar në 4 vitet në vijim. Gjithsesi ky mbetet një sektor kompleks i ndikuar nga fenomene negative si informaliteti i lartë i sektorit dhe përdorimi i lartë i kesh në pagesat për këtë shërbim.

Gjithnjë e më tepër, teknologjia e informacionit po behet një faktor kyç i zhvillimit të turizmit në Shqipëri. Vitet e fundit, Shqipëria ka pasur një shtim të konsiderueshëm të numrit të turistëve nga jashtë, kryesisht nga vendet Evropiane.

Ky trend pozitiv është shoqëruar me sfida, një ndër të cilat është adaptimi me modelet e reja të shërbimit të konsumatorit dhe teknologjisë së informacionit. Një ndër problemet më të cilat haset zhvillimi i turizmit në Shqipëri dhe një sfide për të ardhmen është përdorimi i paket të teknologjisë së Informacionit. Përdorimi i teknologjive të informacionit në industrinë turistike është i kufizuar. Me përjashtim të ndonjë rasti sporadik, zakonisht me ndihmën e organizatave ndërkombëtare, ofrimi i shërbimeve digjitale për turistët është ende i pazhvilluar. Në të njëjtin nivel është përdorimi i tyre, për marketingun e shërbimeve dhe produkteve dhe shitjen në tregje. (Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 – 2023)

---

<sup>12</sup> [https://www.tap-ag.com/assets/07.reference\\_documents/english/Project%20Finance%20Disclosure/Albania%20Livelihood%20Res to ration%20Plan%20\(in%20Albanian\).pdf](https://www.tap-ag.com/assets/07.reference_documents/english/Project%20Finance%20Disclosure/Albania%20Livelihood%20Res%20to%20ration%20Plan%20(in%20Albanian).pdf)

<sup>13</sup> <http://www.mjedisi.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Komb%C3%ABtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>

Operatoret turistike po përdorin gjerësisht teknologjinë e informacionit për promovimin e destinacioneve turistike, ndërveprimin midis operatoreve turistike, dhe rritjen e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të numrit turistëve. Ne këtë kontekst ata kanë krijuar banke të dhënash dhe shkëmbejnë informacionin nëpërmjet mënyrave të ndryshme si Interneti dhe aplikacionet e ndryshme.

Institucionet publike janë mjaftuar kryesisht në hartimin e politikave për zhvillimin e turizmit dhe planeve të veprimit në mbështetje të sezonit turistik.

Qeveria shqiptare ka zhvilluar politikat e nevojshme për të krijuar mjedisin e duhur për zhvillimin e turizmit në përgjithësi dhe digjitalizimin në këtë sektor në veçanti.

Në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2015-2020”, një objektivi është rritja e efikasitetit të sektorit prodhues, bujqësi, turizëm dhe industri nëpërmjet sistemeve të TIK. Me anë të kësaj synohet modernizimi i sektorëve prodhues të vendit nëpërmjet TIK, mundësia e plotësimit të standardeve dhe kualitetit të produkteve dhe shërbimeve në përputhje me direktivat e Komunitetit Evropian (në kuadrin e Objektivës 1. Shtimi dhe promovimi i shërbimeve elektronike, e-shërbimeve, për qytetarët dhe biznesin me 350 shërbime online).

Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 – 2023 ka objektiva dhe masa specifike për zhvillimin e digjitalizimit në sektorin e turizmit. Në kuadrin e Objektivit Politik 4 (Ri-orientimi i Promovimit drejt Potencialëve Turistike), parashikohet Promovimi i Produkteve Turistike gjithëvjetorë brenda dhe jashtë vendit (Objektivi 4.2), ku produktet (ose oferta turistike) e Shqipërisë mund të jenë tepër të larmishme duke filluar që nga destinacionet, vlerat historike dhe kulturore e deri tek prodhimet artizanale, ushqimet, pijet etj. dhe do të promovohen vazhdimisht, jo vetëm përgjatë sezonit veror, duke synuar njëkohësisht edhe audiencën specifike dhe do të synohet ngritja e një strukture pranë përfaqësive tona diplomatike si edhe përdorimi sa më efektiv i kanaleve të tjera të promovimit.

Gjithashtu synohet “Mbështetja e Agjenteve Promovues të vendit në Shqipëri dhe Diasporë” (Objektivi 4.3). Në këtë kontekst, konsideruar se strategjia e zhvillimit dhe promovimit të turizmit është përgjegjësi ndër-institucionale dhe jo vetëm objekt i një institucioni të vetëm, do të synohet drejt inkurajimit të mekanizmave alternativë të promovimit, qoftë këto Agjentë apo Agjenci Turistike që do të angazhohen në promovimin e Shqipërisë drejt një territori të caktuar jashtë Shqipërisë, e duke vijuar edhe me zhvillimin e Teknologjisë së Informacionit si një mjet për promovimin e destinacioneve dhe informimin e vizitorëve. Për këtë qëllim, do të ngrihet një portal informues mbi agjentët e promovimit, destinacionet dhe produktet turistike që mund të zhvillohen në Shqipëri.

Për sa i përket sezonit turistik veror 2019, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.65, datë 01.04.2019 "Për miratimin e Planit të Masave për Sezonit Turistik Veror, 2019, dhe Ngritjen e Task-Forcës për Menaxhimin e tij", është zhvilluar Plani i Masave për sezonin turistik veror 2019 nga Agjencia Kombëtare e Turizmit. Ne këtë kuadër janë parashikuar:

- Të publikohen të dhënat për strukturat akomoduese (kontakte, kapacitete, vendndodhje e shërbime), agjencitë turistike dhe për subjekte të tjera turistike në faqen zyrtare të AKT-së sipas shpërndarjes gjeografike dhe destinacionit turistik (Vënia në dispozicion e të dhënave për ndarje sipas shpërndarjes gjeografike dhe publikim; Publikimi i tyre në faqen zyrtare të AKT-së);
- Të organizojë dhe mbështesë veprimtarinë argëtuese në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, shoqata, institucione qendrore dhe lokale, publike dhe private, etj. (Përcaktimi i aktiviteteve që do të organizojë dhe mbështesë AKT gjatë sezonit turistik; Koordinimi me personat përgjegjës në MTM, për kalendarin kombëtar të aktiviteteve; Publikimi i tyre në faqen zyrtare të AKT-së).
- Të përmirësojë rrjetin e informacionit turistik dhe pajisjen në vazhdimësi me materiale promovuese të stendave promovuese të ngritura në pikat kufitare dhe në ambasadat Shqiptare jashtë vendit. (Sigurimi i materialeve promocionale dhe shpërndarja; Shkresë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Kufirit dhe Migracionit; Përfshirja edhe në kuadër të projektit SMILE Albania).
- Të publikohet kalendari i festave dhe eventeve kombëtare dhe lokale. (Koordinimi me personat përgjegjës në MTM, për kalendarin kombëtar të aktiviteteve; Publikimi i tyre në faqen zyrtare të AKT-s; Komunikimi me MK).

Gjithashtu, institucionet publike kane dhënë edhe mbështetje konkrete për zhvillimin e sektorit të turizmit si grumbullimi dhe shpërndarja e informacionit mbi turizmin në bashkëpunim me institucionet e tjera publike në nivel qendror dhe lokal dhe Drejtorinë e Kufirit, angazhimin e misionëve diplomatike shqiptare jashtë vendit për promovimin e turizmit, mbështetjen e iniciativave private për digjitalizimin në sektorin e turizmit, etj. Për shembull, Albania Discover është një platformë që nisi si fituese e konkursit të sipërmarrjes të krijuara nga ide novatore nga Ministria e Turizmit dhe ofron kanale efektive komunikimi on-line për bizneset në 12 qarqet e Shqipërisë si dhe në Maqedoni dhe Kosovë Zhvillimit në Shqipëri. Platforma përfshin informacion për biznese të ndryshme (te vogla, te mesme dhe te mëdha) dhe destinacionet turistike dhe vendndodhjen e bizneseve të përfshirë në turizëm.

Sidoqoftë, Shqipëria është prapa vendeve të rajonit lidhur me përdorimin e teknologjisë së informacionit për promovimin dhe zhvillimin e turizmit. Ndërlidhja midis destinacioneve, operatoreve turistike, punonjësve të tyre, institucioneve publike përgjegjëse, etj. është e kufizuar. Informacioni që vizitorët japin gjatë qëndrimit të tyre nuk procedohet siç duhet. Njohuritë për përdorimin e këtyre të dhënave që janë shumë të rëndësishme për promovimin e destinacioneve turistike janë të kufizuara. Ndërveprimi me turistët në mënyrë që të identifikohen dhe adresohen

nevojat e tyre nëpërmjet ofertave të duhura turistike, që mund të sigurohet nga digjitalizimi në turizëm është i kufizuar.

Gjithnjë e më tepër, teknologjia e informacionit po bëhet një faktor kyç i zhvillimit të turizmit në Shqipëri. Në këtë kontekst, del si domosdoshmëri:

- Ndryshimi i mënyrës së të menduarit dhe të vepruarit si nga operatorët turistike ashtu edhe nga institucionet publike përgjegjëse për zhvillimin e turizmit për t'ju përshtatur zhvillimit të shpejtë të teknologjisë së informacionit dhe avantazheve të panumërta që ofron ajo. Operatorët private turistike duhet të kontribuojnë në zhvillimin e digjitalizimit duke ofruar eksperiencën dhe informacionin e tyre. Kompanitë e teknologjisë së formacionit duhet të ofrojnë burime solide dhe inteligjente. Start-up duhet të vijnë me ide të reja duke ofruar dinamikizëm dhe fleksibilitet. Përsëri përket sektorit publik, nëpërmjet politikave efektive por edhe mbështetjes konkrete për biznesin e turizmit, duhet të përdorë digjitalizimin dhe rrjetin e institucioneve publike në nivel qendror dhe lokalë si dhe jashtë vendit për të ofruar informacionin e duhur tek operatorët turistike si dhe vizitorët potenciale.
- Digjitalizimi gjithashtu do të thotë që çdo gjë duhet të ndërlihet: destinacionet, fasilitetet, punonjësit, etj. Informacioni që vizitorët japin gjatë qëndrimit të tyre në vend është i madh. Ky informacion duhet të mblihet, përpunohet dhe përdoret në mënyrë korrekte.
- Njohuritë për përdorimin e këtyre të dhënave janë të rëndësishme për promovimin e destinacioneve turistike dhe duhet të zhvillohen për punonjësit e operatorëve turistike dhe institucioneve përgjegjëse.
- Digjitalizimi në turizëm duhet të sigurojë një ndërveprim më të madh me turistët në mënyrë që të identifikohen dhe adresohen nevojat e tyre nëpërmjet ofertave të duhura turistike.

### **e-shërbimet konsullore dhe avantazhet e përdorimit të teknologjisë**

Strategjia Ndersektoriale “Akhenda Digjitale e Shqipërisë 2015-2020” në dokumentin e saj fillestar nuk paraqet fokus në shërbimet konsullore apo ato të lidhura me diplomacinë në vend; megjithatë dukë qenë një dokument ndër sektorial, plani i saj i veprimit parasheh nën objektivin e saj të parë një zë mjaft me peshe për Implementimi i shërbimeve online të Ministrisë së Punëve të Jashtme, zë me vlerë 38,919,120 lekë, i realizuar në masën 145% brenda vitit të parë të zbatimit të strategjisë si raportohet në Raportin e Parë dhe të vetëm të monitorimit të kësaj Strategjie botuar në vitin 2016<sup>14</sup>.

Ky zë dhe ky realizim i shkon në masë të konsiderueshme krijimit dhe funksionimit të shërbimit E-konsullata.

---

<sup>14</sup> <https://www.infrastruktura.gov.al/raport-monitorimi-strategjia-axhenda-dixhitale-2015-2020/>

**E-Konsullata**<sup>15</sup> është një aplikacion informues i shërbimit të jashtëm për të gjithë shtetasit shqiptarë të cilët jetojnë jashtë vendit apo si një udhërrëfyes për sigurinë e shtetasve shqiptarë që ndërmarrin udhëtime në çdo vend të botës. Aplikacioni përdoret edhe për agjencitë e promovimit të investimeve, agjencitë e promovimit të turizmit dhe operatorët turistik. Platforma ka ndihmuar gjithashtu institucionet tona në procesin voluminoz të regjistrimit të shtetasve shqiptar që jetojnë jashtë vendit. Ai mund të shkarkohet nga AppStore apo Playstore duke të mundësuar: kontaktet e plota të çdo përfaqësie shqiptare në botë; informacion mbi procedurat e legalizimeve të dokumenteve; shërbimet e tjera konsullore brenda dhe jashtë vendit; si dhe informacione mbi situatën për secilin prej vendeve pjesë e E-Konsullata. Aplikacioni ka sjellë lehtësuar disi por ka ende vend për përmirësim si në drejtim të pasurimit më tej të gamës së shërbimeve të ofruara ashtu edhe në cilësinë e ofruar.

Ndërkohë një tjetër projekt është ofruar në këtë drejtim. Projekti më madhor i realizuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, *Shërbimi Konsullor Online-SHKO* e cila ofron procedura të automatizuara dhe digjitalizimin e të gjitha shërbimeve konsullore. Kjo platformë erdhi prej angazhimeve të ndërmarra në kuadër të Samitit të Diasporës duke sjellë ndryshime rrënjësore në mënyrën e ofrimit të shërbimit për shtetasit shqiptarë në botë. Tashmë, nëpërmjet projektit SHKO ofrohen procedura të automatizuara, shërbime konsullore dhe regjistra elektronik të digjitalizuar (gjithsej 36 shërbime unike me një siguri të lartë). Konkretisht, qytetarët shqiptarë mund të marrin 23 shërbime online pa pasur nevojë të paraqiten personalisht, dhe 13 shërbime duke u paraqitur vetëm një herë.

Kjo platformë e automatizuar, ka mundësuar të unifikohen të gjitha formatet me elemente të njëjtë duke mundësuar gjurmimin në kohë reale të aplikimit të bërë nga qytetari online, ruajtje në Serverët e Ministrisë së Punëve të Jashtme, të cilët janë të aksesueshëm në çdo kohë duke rritur në këtë mënyrë transparencën.

Përveç reduktimit të ndjeshëm të kohës së marrjes së shërbimeve nga ana e qytetarëve në kuadër të lëshimit të dokumenteve nga ana e Përfaqësive Diplomatike dhe konsullore, ku para kësaj reforme ekzistonin rreth 1000 formate të ndryshme në lidhje me përdorimin e gjuhës; firmën e konsullit; vendosjen e vulave; shkrimin e tekstit; vendosjen e numrave të regjistrimit; përmbajtjen e tekstit; etj. ky shërbim i digjitalizuar ka ndikuar në uljen e kostove si për buxhetin e shtetit ashtu edhe të qytetarëve. Kjo për faktin se shumë shërbime ofrohen falas ndërsa disa të tjera ofrohen me tarifë të reduktuar (për shembull është përgjysmuar tarifa e dublikimit të certifikatave dhe ulur me 25% tarifa e legalizimeve).

Ndërtimi i platformës SHKO ka qenë një sfidë më vete nga ana teknokratike por ka ende hapësirë për gjermisim.

---

<sup>15</sup> App Store - iTunes – Apple: <https://itunes.apple.com/bt/app/e-konsullata/id1135893227...> Android Apps on Google Play: <https://play.google.com/store/apps/details...>

Në kontekstin e digjitalizimit të shërbimit konsullor, statistikave tregojnë një përdorim të lartë të sistemeve elektronike nga ana e qytetarëve, ku, duke ju referuar raportit të AKSHI të vitit 2018<sup>16</sup> referohen të jenë kryer 63,700 aplikime për shërbimet e konsullatave dhe 106,600 aplikime prej shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit.

## **EBC në vend të ABC: eEdukimi dhe arsimit shqiptar në rrjet**

**Objektivi 3 i strategjisë Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2015-2020, është i dedikuar plotësisht arsimit, me nën objektiva të qartë dhe të mirë planifikuar në planin e saj të veprimit.**

*“Dixhitalizimi i sistemit arsimor për të rritur cilësinë e arsimit dhe kontribuar në krijimin e një shoqëri bazuar në dije nëpërmjet rritjes së aksesit në kurrikula dixhitale dhe mundësimin të lidhjes të tyre në internet (100%)”<sup>17</sup>*

Integrimi në një nivel bashkëkohor të përdorimit të TIK në mësimdhënie e mësim-nxënie, ku të gjithë aktorët si mësuesit, prindërit, nxënësit, politikë bërësit dhe ofruesit e shërbimeve luajnë role të përcaktuara në krijimin e hapësirave të e-Edukimit, shihet nga kjo Strategji si kryesor për kalimin gradual drejt një shoqërie digjitale bazuar në dije.

Armata e revolucionit të 4<sup>rt</sup> industrial të njerëzimit e ka filluar njohjen dhe trajnimin me mjetet e teknologjisë dhe inovacionit shumë herët. Moshë e prezantimit me mjetet e TIK dhe përdorimin e tyre po ulet ndjeshëm, ndërkohë që metodat e edukimit tradicional po transformohen me shpejtësi dhe po ndryshojnë konceptin e arsimit, klasave e institucioneve arsimore dhe botën e punës.

Alfabeti fillon tashme nga e-për e-Edukim. Aftësitë për punë të nevojshme për shekullin, kanë pësuar ndryshime të thella prej vitit 2015. Raporti i Forumit Botëror Ekonomik për 2019<sup>18</sup>, ndërsa shpalos përparësitë dhe përfitimet e digjitalizimit të jetës, paralelisht ngre dhe shumë sfida që duhen përballuar shumë shpejt në strategjitë e përgatitjes së forcave të punës për tregun e madh botëror, sfida që ecin tashmë me shpejtësi 5G. Hendeku mes njohurive të marra në edukim dhe aftësive për punë të kërkuara në treg, është ende i konsiderueshëm edhe në rang global dhe shumë industri janë në garë. Për mbylljen e hendekut të aftësive që merren mes arsimit dhe tregut të punës po hapen muret e klasave, shkollave, universiteteve. Po ndryshon koncepti i komunitetit arsimor, teknikave dhe organizimit të arsimit.

Po Shqipëria ku qëndron në këtë aspekt? Objektivi i tretë i prioritetit të dytë të Agjendës Shqipëria Digjitale, si u citua dhe më sipër shprehimisht synon: *Dixhitalizimi i sistemit arsimor për të rritur cilësinë e arsimit dhe kontribuar në krijimin e një shoqëri bazuar në dije nëpërmjet rritjes së aksesit në kurrikula digjitale dhe mundësimin të lidhjes të tyre në internet (100%).*

<sup>16</sup> <http://akshi.gov.al/raporte-vjetore/>

<sup>17</sup> [http://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Strategjia\\_Axhenda\\_Dixhitale\\_e\\_Shqiperise\\_2015-2020.pdf](http://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Strategjia_Axhenda_Dixhitale_e_Shqiperise_2015-2020.pdf) 32

<sup>18</sup> [http://www3.weforum.org/docs/WEF\\_Future\\_of\\_Jobs\\_2018.pdf](http://www3.weforum.org/docs/WEF_Future_of_Jobs_2018.pdf)

Natyrshëm që realizimi i këtij objektivi kërkon disa parakushte, plotësimi i të cilave është i domosdoshëm për sukses.

Pajisja e shkollave me infrastrukturë funksionale për shfrytëzimin e informacionit (kompjuter, laptop, tabletave smart); aksesimi në Internet me shpejtësi të lartë dhe mundësi aksesimi online edhe në mjedise të tjera brenda shkollave, mundësi aksesimi në portalet e arsimit në përputhje me kurrikulën e planifikuar si dhe në portale që mundësojnë monitorimin e rezultateve të nxënësve nga mësuesit dhe prindërit e tyre; zhvillimi i kompetencave në përfitimin e këtyre shërbimeve të ofruara nëpërmjet optimizimit të shërbimeve të ofruara në sistemet software-ike janë kushtet që vete strategjia i parashtron te domosdoshme për sukses. Për të shtuar këtu edhe një faktor vështirësish të matshëm, që është kultura e përdorimit të Internetit për qëllime mësimore si nga mësuesit nxënësit dhe prindërit, e cila është e munguar.

2.8 celularë broadband janë sot në duart e shqiptareve dhe me shkallë mbulimi me shërbimin e internetit 78% në zonat urbane dhe 63% në ato rurale, duket se krijojnë parakushtet që gjithë popullata të ketë akses në rrjet edhe për qëllimi edukimi, po sa ndodh kjo është pak e matshme. Raporti i monitorimit të ASGJ 2015-2020 citon se në 2016 është realizuar 34% e aktiviteteve të parashikuara në këtë drejtim nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Pajisja e 60 shkollave të mesme me tableta për mësimdhënien digjitale është mbyllur në 2016, dhe 120 laboratorë janë pajisur me lidhje interneti të shpejtë dhe kompjuterë funksionale. Në raport me numrin total të shkollave të mesme, në rang vendi, raportuar 495 nga Vjetari Statistikor për Arsimin 2017 -2018<sup>19</sup>, vetëm në 25% të tyre është infrastruktura e nevojshme për edukimin digjital.

Aq sa është e rëndësishme infrastruktura për e-Edukim, po aq është edhe për administrimin e sistemit arsimit. Ndërthurja e e-shërbimeve me ato arsimore është domosdoshmëri. Sistemi e-regjistër dhe Amza digjitale janë përrkundur tashme dhe po pilotohen për përdorim me anë të trajnimit të një pjese të mësuesve dhe administratorëve të sistemeve të menaxhimit arsimit në formë digjitale.

Rrjetëzimi online i gjithë shkollave të arsimit publik dhe privat të mesëm në vend është rritur, por është një tregues i pamatur prej vitit 2016. Platformat e menaxhimit të mësuesve dhe punësimit dhe edukimit të vazhdueshëm po sjell risi në menaxhimin e sistemit arsimor, por ende duhet rritur shkalla e transparencës dhe përdorimi efektiv i tyre në të gjithë territorin.

Në arsimin fillor dhe atë baze, e-Edukimi si për nxënës dhe mësues është ende në faza pilotimi. Janë fondet e donatoreve të huaj ato që prej vitit 2016 kanë bërë të mundur realizimin e projekteve pilot për digjitalizimin në arsimin e mesëm, projektet pilot si “I Learn/Unë mësoj”, financuar nga

---

<sup>19</sup> <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2019/01/Vjetari-statistikor-2016-2017-varianti-per-botim.pdf>



Programi Italo-Shqiptar për Konvertimin e Borxhit për Zhvillim (IADSA 2016), dhe platformat multimediale edukuese për nxënës dhe mësues të sistemit të arsimit fillor, “SchoolME” dhe “TeachPitch” financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (2018), janë të vetmet që sigurojnë vijueshmërinë e investimeve për e-Edukim në këtë sistem.

E ndërtuar nga një operator privat nga diaspora shqiptare, SchoolME<sup>20</sup> është një platformë interaktive e të mësuarit, një inovacion në kufijtë e revolucionit për arsimin shqipfolës, dhe ka një histori suksesi në Kosovë prej 4 vitesh dhe në Shqipëri në më pak se dy. SchoolMe nëpërmjet marrëveshjeje me Ministrinë e Arsimit të Kosovës dhe mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Kosovën, pas një pilotimi të suksesshëm, dhe vlerësimit në Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020<sup>21</sup>, është parashikuar të mbështetet nga buxheti i shtetit për vitin 2019-2021.

Në Shqipëri, platforma u pilotua në 35 shkolla të vendit gjatë vitit akademik 2018-2019, me mbështetjen financiare të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Duke ju referuar dokumentit të vlerësimit të Institutit për Zhvillimet e Arsimit -IZHA sot Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar - ASCAP, Nr.322 Prot, datë 24.04.2019, platforma ofron materiale të vlefshme, me cilësi që ndihmojnë nxënësit në procesin e të nxënës dhe mësuesit në mësimdhënie.

Në vitin 2019-2020, kodet e përdorimit të nxënësve të këtyre shkollave janë mbyllur fakt që kërkon për ndërhyrje buxhetore nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë për të siguruar vijueshmëri të efekteve pozitive të saj.

Edhe pse buxhetet vjetore të MASR dhe atyre të linjës alokojnë fonde për digjitalizimin e arsimit, ende ka nevojë për vëmendje dhe investime qeveritare për përshkallëzimin e shpejtë të përdorimit të TIK në mësimdhënie<sup>22</sup>. Me gjithë optimizimin dhe strategjitë vizionare, faktet infrastrukturore flasin për një përparim të ngadaltë të e-Edukimit. Me raportin kompjuter për nxënës 25/1 në sistemin arsimor parashkollor, progresi do të jetë i vështirë. Kurrikula me në qendër nxënësin dhe reformimi i sistemit arsimor si nga ana logjistike e infrastrukturore dhe nga rritja e vazhdueshme e kapaciteteve të mësuesve në përdorimin e mjeteve TIK në mësimdhënie, janë premisa pozitive po duhen intensifikuar dhe matur objektivistisht progresi i tyre.

Nëse shohim edhe prioritetet e PBA 2019-2021, asnjë prej tyre në sektorin e arsimit nuk përmend as kithtasi digjitalizimin e shkollave veç ndërtimin dhe rikonstruksionin e tyre.

---

<sup>20</sup> <https://www.schoolme.education/landing/>

<sup>21</sup> <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/libri-b5-shqip.pdf>

<http://kfos.org/wp-content/uploads/2017/04/soros-raporti-2016-05-04-2017.pdf>

<sup>22</sup> DIGITAL SKILLS AND ONLINE LEARNING IN ALBANIA – European Training Foundation, 2018



Si u parashtrua edhe në hyrje të këtij punimi, është shume e rëndësishme edukimi në funksion të marrjes se shërbimeve dhe kërimit të cilësisë dhe shpejtësisë në marrjen e tyre. Edukimi i hershëm me përdorimin e TIK për këtë qëllim, paralelisht në bankat e shkollës do të ndihmojë progresin në këtë drejtim.

## PËRFUNDIME

Përdorimi i TIK në shërbimet publike mbetet një prioritet i qeverisë shqiptare, dhe arritjet janë të dukshme, por jo uniforme dhe efektive në të gjithë popullatën që i përdor këto shërbime. Punimi i mësipërm, reflekton mbi disa fusha të shërbimeve të mëgjithatë, lëvizja dhe zhvillimet super të shpejta të përdorimit të teknologjisë në shërbim të qytetareve kërkojnë si reagim në nivel infrastrukturor, ashtu edhe në edukimin dhe asistencën për qytetarët në përdorimin e këtyre shërbimeve. Rekomandimet e mëposhtme modeste, vijnë si mundësi për përmirësim dhe vëzhgim jo vetëm si studentë po edhe si qytetarë, taksapagues dhe konsumatorë të këtyre shërbimeve publike.

*- Sistemi i regjistrimit duhet të zhvillojë në mënyrë të vazhdueshme ambjentin rregullativ tekniko-ligjor, në funksion të sigurisë së tregut të pasurive.*

- Duhet përmirësuar koordinimi mes institucioneve që prodhojnë dokumente ligjore, të finalizohet regjistrimi i të drejtave të pasurive dhe garantimi i tregut të tyre bëhet edhe më i vështirë. Në Shqipëri ka nevojë të mëdha për përmirësim në fushën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe garantimit të tregut!

- Sektori publik, nëpërmjet politikave efektive por edhe ,mbështetjes konkrete për biznesin e turizmit, duhet të përdorë digjitalizimin dhe rrjetin e institucioneve publike në nivel qendror dhe lokal si dhe jashtë vendit për të ofruar informacionin e duhur tek operatorët turistikë si dhe vizitorët potenciale.

- Të rriten njohuritë për përdorimin e këtyre të dhënave për E-Turism si për promovimin e destinacioneve turistike ashtu edhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarë e pushuesve vende e të huaj.

- Digjitalizimi në turizëm duhet të sigurojë një ndërveprim më të madh me turistët në mënyrë që të identifikohen dhe adresohen nevojat e tyre nëpërmjet ofertave të duhura turistike.

- Ndërthurja e e-shërbimeve me ato arsimore është domosdoshmëri. Trajnimit i vazhdueshëm i mësuesve dhe administratorëve të sistemeve të menaxhimit arsimor në forme digjitale duhet të intensifikohet dhe matet progresi në mënyrë objektive.

- Nevojiten investime në infrastrukturën digjitale për përshkallëzimin e shpejtë të përdorimit efektiv të TIK në mësimdhënie dhe nxënie për t'ju afruar ritmeve të e-edukimit në rajon.

## Aneks 1 Përmbledhje e bazës ligjore mbi digjitalizimin në Shqipëri

- Vendim nr.495, date 13.9.2017 “Për miratimin e Rregullave të Përfitimit të Shërbimeve Publike Elektronike”
- Vendim nr.496 Për Disa Shtresa në vendimin nr.332,” Për Përcaktimin e Formës, Elementëve Përbërës, Mënyrës së Mbajtjes e Afatit të Përdorimit të Dokumenteve Bazë, që Mbahen dhe Lëshohen nga Shërbimi i Gjendjes Civile”
- Vendim nr.673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”
- VKM nr 15/12.1.2018
- Ligji Nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për Nënshkrimin Elektronik”
- Legjislacioni mbi Krimin Kibernetik
- Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”
- Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”
- Strategjia Ndërsektoriale e Shoqërisë së Informacionit
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 303, datë 31.03.2011 “Për Krijimin e Njësive të Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit në Ministrinë e Linjës dhe Institucionet e Varësisë”
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 357, datë 24.4.2013 për miratimin e rregullores “Për Menaxhimin e Dokumentit Elektronik në Republikën e Shqipërisë”
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 778, datë 07.11.2012, “Për Miratimin e Standardeve të Përgjithshme, Minimale, të Personelit NjTIK për Strukturimin Organizativ të Njësive të Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit”
- Vendim Nr. 914 ,datë 29.12.2014 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, I NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 402, DATË 13.05.2015, ME VENDIMIN NR. 1046, DATË 23.12.2015, VENDIMIN NR. 823, DATË 23.11.2016 DHE VENDIMIN NR. 893, DATË 21.12.2016
- Udhëzim nr. 2 datë 2.9.2013 i Ministrisë për ITIK “Për standardizimin e hartimit të Termave të Referencës për projektet TIK në administratën publike”
- Rregullore për politikën e privatësisë
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 277 datë 29.3.2017 “Për Miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 322, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”
- Urdhër i Kryeministrit Nr. 124, datë 9.06.2010 “Për Ngritjen e Grupit Këshillimor ‘Forumit Kombëtar për Shqipërinë Digjitale”
- Urdhër i Kryeministrit Nr. 119, datë 2.06.2010 “Për Ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës, për Bashkërendimin e Punës dhe Zhvillimin e Rrjetit Kombëtar me Brez të Gjerë (National Broadband Backbone)

- Urdhër i Kryeministrit Nr. 70, datë 12.06.2012 “Për Ngritjen e Komitetit Ndërministror për Zbatimin e Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike“
- Ligji Nr.10132, datë 11.05.2009, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 46/2015, “Për Shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.(Fletorja zyrtare 86)
- Urdhër i Kryeministrit Nr. 202, datë 16.12.2005 “FORCIMIN E TRANSPARENCËS, NËPËRMJET RRRITJES SË PËRDORIMIT TË INTERNETIT DHE PËRMIRËSIMIT TË FAQEVE EKZISTUESE TË INTERNETIT”
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 27.07.2000 “Për Kushtet e Nxjerrjes së Pullës Postare Shqiptare”
- Ligji Nr. 10 273, datë 29.04.2010 “Për Dokumentin Elektronik”
- Udhëzim i Ministrit për ITIK Nr. 1, datë 31.12 .2012 “Për Vërtetimin e Kopjes në Letër të Dokumentit Elektronik nga Institucionet Publike“
- Ligji Nr. 10 325, datë 23.09.2010 “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 961, datë 24.11.2010 “Për Përcaktimin e Autoritetit Rregullator Koordinues të Bazave të të Dhënave Shtetërore”
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 945, datë 2.11.2012 “Për Miratimin e Rregullores ‘Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore”
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 734 datë 28.08.2013 “Për Krijimin e Sistemit Unik të Regjistrimit, Autentifikimit dhe Identifikimit të Përdoruesve në Marrjen e Shërbimeve
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 710 datë 21 gusht 2013 Për Krijimin dhe Funkcionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmerisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”